



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.09

Prishtinë, më 20.11.2017, në orën:13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Arban Abrashi dhe Imet Rrahmani.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësues të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, OSBE, INPO.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.11.2017;
3. Diskutim në lidhje me nismën legjislative për hartimin e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.11.2017;

Procesverbali u miratuan pa vërejtje.

3. Diskutim në lidhje me nismën legislative për hartimin e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

Nait Hasani, iu propozoi anëtarëve të Komisionit që për propozimet e poshtëshënuara rreth përkufizimeve për tekstin e P/ligjit, të deklarohen për miratimin e tyre, apo refuzimin, në mënyrë që Komisioni të vazhdojë me propozimet tjera për nenet e P/ligjit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- nënkupton institucionin e pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil

Nëpunës civil – nënkupton nëpunësin civil sipas përkufizimit në Ligjin për Shërbimin Civil;

Nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues –nënkupton nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues, sipas përkufizimit në Ligjin për Shërbimin Civil;

Nëpunës civil i nivelit drejtues –nënkupton nëpunësit civilë të nivelit drejtues sipas përkufizimit në Ligjin për Shërbimin Civil;

Përfundimi i rregulltë i mandatit – nënkupton përfundimin e mandatit të anëtarit të Këshillit pas skadimit të afatit ligjor të emërimit;

Ankues –nënkupton nëpunësin civil apo kandidatin për pranim në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit;

Personi përgjegjës për zbatimin e Vendimit të Këshillit- nënkupton zyrtarin e nivelit të lartë drejtues ose zyrtarin/zyrtarët përgjegjës të organit të punësimit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës apo që është obliguar nga Këshilli për zbatimin e Vendimit;

Seancë profesionale – nënkupton seancën e organizuar nga Këshilli për diskutimin dhe shqyrtimin e çështjeve profesionale, zbrazëtirave ligjore dhe vështirësive në zbatimin e legjislacionit.

ShqipePantina, kërkoi sqarim për definicionin e sipërshënuar – seancë profesionale.

Lulzim Aliu, KPMSHCK,tha se në Këshill mbahen, përveç seancave profesionale, si fjala vjen seanca, dëgjimi i palëve etj., për dallim të të cilave seanca profesionale është me e veçantë.

Ai, gjithashtu i dha arsye time rreth disa propozimeve:

- tek funksionet, ishte shtuar fjala “edhe për zyrtarët e nivelit të lartë drejtues”,

- vendosja e ankesave nga Kolegji,

- shqyrtimi dhe vendosja e ankesave, vendimmarrja në afat prej 90 ditëve, konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

- çështja e procedurës së vëzhgimit – ndaj të cilës nuk lejohet ankesa e organit të punësimit,

- definicioni,monitorimi i institucioneve,është bartë,si term, tek kompetencat e Këshillit,

- publikimi i vendimeve në ueb faqen e Këshillit,

- komunikimi elektronik që nënkupton të drejtën e paraqitjes së ankesës në formën elektronike,

- dhe obligimin e institucioneve për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit.

Konstatim: Komisioni miratoi të gjitha propozimet e sipërshënuara.

Mbledhja përfundoi në orën:15:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani